



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01 Nr. 400/AS-1856
Datë: 08.02.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (a) dhe (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenit 10 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, duke vendosur lidhur me kërkesën e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për subvencionimin me mekanizëm bujqësor, më datën 08.02.2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet zotimi dhe pagesa e mjeteve financiare të subvencioneve në vlerë prej 11,840.00€ për realizimin e projekteve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për furnizimin me mekanizëm bujqësor, për fermerët e Komunës së Gjakovës sipas thirrjes publike, me numër 08-320/01-16678.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të realizojnë procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 11,840.00€ dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e operatorit ekonomik N.P.T “HAXHIJAH” Sh.p.k me numër [REDACTED].

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës – Zyra e Prokurimit ka lidhur kontratë me operatorin ekonomik N.P.T “HAXHIJAH” Sh.p.k për furnizimin me mjete për bujqësi, me numër identifikues – [REDACTED]

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me datën 24.08.2023 ka bërë thirrje publike për të gjithë fermerët e Komunës së Gjakovës për subvencionimin në kuadër të sektorëve të Lavërtarisë, Perimtarisë, Pemëtarisë, Vreshtarisë dhe Blegtorisë.

Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve për subvencionimin sipas thirrjes publike ka bërë përzgjedhjen e fermerëve në bazë të kriterëve të parapara. Pas përzgjedhjes së fermerëve nga komisioni për vlerësimin e aplikacioneve, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural ka lidhur memorandum bashkëpunimi me fermerët e përzgjedhur sipas raportit të Komisionit të vlerësimit, në të cilët fermerët kanë kontribuar me mjete financiare në vlerë prej 20% në shumë të përgjithshme.

Komisioni komunal dhe menaxheri i projektit për mbikëqyrjen e procesit të implementimit të kontratës ka nxjerrë proces me të cilën ka konstatuar se projekti është përmbushur sipas specifikave të kontratës mes Komunës së Gjakovës dhe operatorit ekonomik N.P.T “HAXHIJAH” Sh.p.k.

Andaj, nga të lartcekurat urdhërohet Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që t’i kryejnë të gjitha obligimet që rrjedhin nga Kontrata e cekur më lartë dhe mbi bazën e raporteve të dorëzuara nga zyrtarët përgjegjës në harmoni të plotë me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, t’i kryejnë obligimet e pagesës së mjeteve financiare në vlerë prej 11,840.00€ operatorit ekonomik N.P.T “HAXHIJAH” Sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i’ u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Arkivit.


Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës